



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2024:022521

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05734285

C.nr.19/2024

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Artan Abazi, me bashkëpunëtorin profesional Irfan Thaqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.J.nga, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fadil Sinanaj, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës - Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e të ardhurave shtesë në bazë të kualifikimit-licencimit dhe inflacionit, me vlerë të kontestit 3,166.05 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 24.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. PJESËRISHT APROVOHET si e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditësit N. J. nga dhe Detyrohet e paditura Komuna e Kamenicës, që paditësit në emër të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim shkollor – fakultet, në lartësi 27 % të pagës bazë për periudhën nga data 11.01.2021 deri më datë 06.02.2023, shumën nga 113.67 euro për çdo muaj, e këto në shumë prej 2,435.40 euro, ndërsa në emër të inflacionit prej datës 11.01.2021 për 3.4% të inflacionit, shumën prej 187.27 euro, dhe për vitin (*janar – nëntor*) 2022 për 11.6% të inflacionit, shumën prej 532.44 euro, këto në shumë prej 719.64 euro, e në shumë të përgjithshme të hollave prej **3,155.04 euro**, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë, të gjitha këto në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë për kompensimin në bazë të inflacionit për vitin 2020, në shumë prej 11.01 euro, **REFUZOHET SI E PA BAZUAR.**

III. DETYROHET e paditura, që paditësit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 134.00 euro, në afat prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m i

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, më datë 22.01.2022, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Kamenicës-Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e të ardhurave në

bazë të licencimit dhe inflacionit, me vlerë të kontestit prej 3,166.05 €. Në padi ka theksuar se i njëjti është në marrëdhënie pune të e paditura në Gjymnazin “Ismail Qemali”, në Kamenicë, dhe është i licencuar, nga gjykata ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit në emër të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim shkollor – fakultet, në lartësi 27 % të pagës bazë për periudhën nga viti 2020 deri në vitin 2023, sipas pagës bazë 459.00 euro, këto në shumë prej 2,435.40 euro, ndërsa në emër të inflacionit prej vitit 2020 për 0.2% të inflacionit, shumë prej 11.01 euro, për vitin 2021 për 3.4 % të inflacionit, shumë prej 187.20 euro, ndërsa për vitin 2022, për 11.6% të inflacionit, shumë prej 532.44 euro, këto në shumë prej 730.65 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditë, pas datës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor. Baza ligjore lidhur me këtë kërkesë ka theksuar se gjendet në Kontratën Kolektive të Arsimit, neni 35, paragrafi 10, dhe Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr. 01/33 të datës 29.08.2008, Udhëzimin Administrativ nr. 24/2014, nenin 21.

Gjykata konform nenit 394, 395 dhe 396 të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në vijim: LPK-së) të paditurës i ka dërguar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat e bashkëngjitura padisë për tu deklaruar me shkrim në padinë e paditësit.

E paditura përmes përgjigjes në padi, ka theksuar se e kundërshton në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke shtuar se nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune të e paditura, mirëpo KKAK nuk është regjistruar në MPMS-së, ashtu siq kërkohet me Udhëzimin Administrativ nr.12/2021, për regjistrimin e Marrëveshjeve Kolektive, nga ky fakt nuk prodhon efekt juridik, po ashtu ka theksuar se në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.5/2017, “licenca për mësimdhënësit lëshohet për një periudhë 5 vjeqare ndërsa paditësi është me licencë të skaduar dhe të njëjtit nuk ka zbatuar udhëzimin administrativ lidhur me vazhdimin e licencës. Po ashtu ka theksuar se të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vjetësh nga dita e paraqitjes së padisë, në rastin konkret për diferencën në pagë dhe inflacion kemi prarshkrim. Gjykatës i ka propozuar të refuzojë të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi që nga përgjigja në padi rezulton qartas se padia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Gjykata, ka gjetur se mes palëve nuk janë kontestuese faktet se paditësi është i punësuar pranë të paditurës, as paga bazë apo kompensimet e shtesave, por kontestues është fakti se a ka bazë ligjore për kompensim të kualifikimit-licencimit dhe inflacionit për paditësin. Nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune të e paditura në pozitën e mësimdhënësit të kualifikuar me fakultet, (fakt i vërtetuar edhe nga diploma nr.4874 e dt.01.02.1985); dhe se i njëjti për kualifikim-fakultet është paguar në shumë prej 31.84 euro, sipas pagën bazë në shumë prej 459.00 euro (fakt i bazuar nga lista e pagave në emër të paditësit). Ndërsa kërkesa e

paditësit për shpërblimin në bazë të inflacionit, bazën ligjore e ka në nenin 35 paragrafi 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë /Kontrata e datës 18.04.2017, ngase në nenin përkatës është përcaktuar se: “ Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë.”, e në rastin konkret gjykata e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses nga të dhënat se shkalla mesatare vjetore e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, periudhën për vitin për vitin 2021 (për 12 muaj), mesataren vjetore prej 3.4%, edhe për vitin 2022 (për 10 muaj), mesataren vjetore prej 11.4%, këto në bazë të pagës bazë prej 459.00 euro.

Gjykata, para se të vendos në mënyrë meritore në këtë çështje kontestimore i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së, me të cilin përcaktohet se “ kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi, pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga ana e të paditurës, respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike, se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura.

Andaj, gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtave subjektive të paditësit dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017 dhe Kontratës kolektive në fuqi të datës 22.01.2021, konkretisht nenin 7 të kësaj Kontrate, si dhe Mendimit juridik me nr.prot.214/2023, të datës 09.10.2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr.01/33 i datës 29.08.2008, ndërsa procedura është zhvilluar në bazë të Ligjit të Procedurës Kontestimore në fuqi.

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Po ashtu gjykata vlerësoi se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi themelësia e kërkesëpadiisë, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008 dhe Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë.

Në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri më datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Nr.08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe bashkëpunorëve profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me nje ngritje te pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35 %.

Ndërsa në KKAK e datës 18.04.2017, në nenin 35 paragrafi 10 të Kontratës është përcaktuar se: “ Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë ”, në rastin konkret për vitin 2021 dhe 2022.

Zbatimi i këtij vendimi të Qeverisë, në rastet e kualifikimit-licencimit është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Në rastin konkret, gjykata vlerësoi se e paditura nuk ia ka kompensuar paditësit pagën sipas përqindjes për shkak të kualifikimit shkollor, përkatësisht me kualifikim- Fakultet, pasi i njëjti është paguar për vitin 2021 dhe 2022, në shumën prej nga 31.84 euro për kualifikim, në muaj, sipas pagës bazë prej 459.00 euro, ndërsa sipas përqindjes së përcaktuar në Vendimin e Qeverisë, është dashur të paguhet për 27 % të pagës bazë, me ç'rast i ka mbetur borxh paditësit në shumën prej 92.09 euro, për vitet 2021 dhe 2022, ndërsa në emër të inflacionit për vitin 2021, mesataren vjetore prej 3.4%, edhe për vitin 2022, mesataren vjetore prej 11.6%, këto në shumë prej 730.65 euro. Gjykata pati parasysh edhe parashkrimin sa i përketë kërkesëpadisë për kualifikim-licencim, mirëpo lartësia e kompensimit është aprovuar në tërësi, meqë lartësia e shumës së kërkuar dhe vlerësimi i parashkrimit nga dt.11.01.2021, do të ishte me e lartë, e që gjykata në rastin konkret do të gjykonte jashtë kërkesave të palës paditëse (me lartë se vlera e kontestit mbi këtë bazë).

Sa i përketë lartësisë së kërkesëpadisë për shumën e gjetura dhe aprovuara, gjykata ka vendosur pa nxjerrë ekspertizë përkatëse për shkak të ekonomizmit të procedurës, shumën ishin të qarta dhe lehtë të kalkulueshme për gjykatën.

Nga këto arsye, gjykata detyroi të paditurën t'ia kompensojë shumën e përcaktuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në emër të kompensimit të kualifikimit shkollor – përkatësisht diferencën e papaguar dhe inflacionit.

Gjykata, vlerëson se pretendimet e të paditurës të parashtruar me përgjigjen në padi se KKAK-së nuk është regjistruar në MPMS-së, ashtu siq kërkohet me Udhëzimin Administrativnr.12/2021, për regjistrimin e Marrëveshjeve Kolektive, nga ky fakt nuk prodhon efekt juridik, me tutje ka shtuar se nuk ka buxhet për zbatimin e kësaj kontrate, si dhe në bazë të nenit 12 parag.1 të Udhëzimit Administrativ nr.5/2017, sistemi i licencimit dhe zveçillimit të mesimdhënësve në karrierë, shihet se mesimdhënësit janë me licenca të skaduara, duke përfshirë edhe kundërshtimet tjera të cekura në përgjigjen në padi, gjykata vlerëson se këto pretendime janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme, pasi që KKAK është lidhur në nivel vendi sipas dispozitave të nenit 90 Ligjit të Punës, çka nënkupton se meqë KKAK është e lidhur në nivel vendi, e njëjta prodhon efekt juridik edhe ndaj komunës së Kamenicës, këtu të paditurës. Pos kësaj, edhe me nenin 2 parag.1 pika 1.1 të KKAK-së, në mënyrë shprehimore është paraparë se: “Dispozitat e kësaj kontrate janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet e Arsimit Parauniversitar.....”, ndërsa me pikën 1.2 të po këtij neni, është cektur se: “Dispozitat e kësaj Kontrate janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e arsimit (Komunat-DKA, KD të Universiteve e institucioneve të arsimit të lartë,

MASHT-in etj)...”. Në interpretim të kësaj dispozite, gjykata vlerëson se e paditura ka përgjegjësi në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara nga KKAK, pasi që me këtë dispozitë është cekur qartë se të punësuarit por edhe punëdhënësit janë të detyruar t’i zbatojnë dispozitat e kësaj kontrate, andaj edhe të njejtët janë përgjegjëse në përmbushjen e detyrimeve të cilat dalin nga KKAK-së.

Gjykata, sa i përketë kërkesëpadisë për kompensimin në bazë të inflacionit për vitin 2020, në shumë prej 11.01 euro, e refuzoi si të pa bazuar nga fakti se kërkesa e paditësit është parashkruar, respektivisht është paraqitur pas kalimit të afatit tre (3) vjeçar, konform nenit 87 të Ligjit të Punës të Kosovës, ngase paditësi padinë në gjykatë e ka paraqitur me datë 11.01.2024, e që rrjedhimisht paditësi e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës nga dt.11.01.2021, prandaj gjykata ka vlerësuar se pretendimet e të paditës se kërkesat e paditësit janë parashkruar qëndrojnë pjesërisht, e nga ky fakt edhe ka vendosur si në pikën II të dispozitivit.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësit në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ashtu që ia njohi kërkesën e shpenzimeve sa i përket përpilimit të padisë dhe taksës gjyqësore, si shpenzime të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartëcekurat e bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA NË KAMENICË
Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil
C.nr.19/2024, më datë 24.05.2024

Gjyqtari,
Artan Abazi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit, përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2024:022521
Datë: 24.05.2024
Numri i dokumentit: 05734285